



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:058792

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05745873

**C.nr. 999/23**

**Gjykata Themelore Prizren - dega Suharekë**, gjyqtari Robert Tunaj me sek. Juridike F. Kabashi, në kontestin e paditësit R.T nga fsh. G, të cilin e përfaqëson av. I.XH. K nga Suhareka, kundër të paditurës NP “Vista” të cilin e perf. av. R. G nga S, për shkak të kompensimit të dëmit, pas përfundimit të seancës kryesore, me dt. 14.05.2024, në prezencën e të autorizuarve të palëve, me datën 28.05.2024, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET në tërësi e pa bazuar** kërkesëpadia e paditësit R. T nga fsh. G, me të cilën ka kërkuar “të obligohet e paditura NP “Vista” me seli në fsh. S, që paditësit ti kompensoi demin material të shkaktuar me dt. 27.10.2025 si pasojë e dëmtimit të zeros në shtëpinë e tij në shumë prej 1410 €, me kamat ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë e deri ne pagesën definitive, si dhe te obligohet e paditura me shpenzimet e procedurës në shumë prej 1109 €”.

Detyrohet paditësi që të paditurës ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1047 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi R.T nga fsh. G, në këtë gjykatë ka inicuar procedurën sipas padisë për kompensim demi me dt. 07.12.2015 ndaj të paditurve KEDS distrikti në P, dhe NP “Vista” me seli në S.

Ne procesverbal për shqyrtimin kryesor me dt. 27.09.2017 paditësi e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës së parë KEDS Distrikti në P.

Gjykata ne këtë qështje ka nxjerrë aktgjykim për shkak të mos bindjes me dt. 27.09.2017, me Aktgjykimin C.nr. 454/15. Mirëpo ky aktgjykim me Aktvendimin AC.nr. 5153/17 të dt. 07.04.2020 të Gjykatës së Apelit te Kosovës në Prishtinë sipas ankesës së të paditurës NP “Vista “ me seli në S, është prishur dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas kthimit të çështjes në rivendosje ka nxjerrë aktgjykim për shkak te mungesës me dt. 16.06.2020 e qe mban numrin C.nr. 166/20. Edhe ky aktgjykim është prishur me ankesën e të paditurës NP “Vista” dhe çështja është kthyer ne rigjykim dhe vendosje te

serishme me pretendimin se gjykata fare nuk është marr me të paditurën e parë KEDS në Prizren pasi që nuk ka pasur vendimmarrje dhe nuk ka pasur prova se paditësi ka tërhequr padinë apo ka heq dorë nga kërkesëpadia.

Gjykata pas kthimit në ri vendosje me procesverbalin e datës 27.11.2023 ka konstatuar me aktvendim procedural se padia e paditësit ndaj të paditurës KEDS distrikti në P, është tërhequr dhe ka vazhduar çështjen sipas padisë ndaj të paditurës NP “Vista “ me seli në S.

E autorizuar e paditësit në seancë për shqyrtim të padisë i ka propozuar gjykatës që me qellim të konstatimit të drejtë dhe vërtetimit të shkaktarit të dëmit të nxirret ekspertizë me ekspert të elektro energjetikës dhe të administrohen provat e propozuara në padi dhe atë procesverbali mbi konstatimin e dëmit me nr. 2563 i dt. 03.11.2015, shkresat mbi kalkulimin e dëmit e hartuar nga vet paditësi pa datë dhe numër duke propozuar të dëgjohen edhe dëshmitaret Sh. S dhe V. G.

Ne fjalën përfundimtare ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar fakti se djegëja respektivisht shkaktimi i dëmit karshi paditësit ka ardhur si pasojë e këputjes së përcuesit zero, gjë që është vërtetuar edhe nga operatori i mirëmbajtjes së rrjetit elektrik KEDS dhe shkaktari i dëmit ka qene e paditura NP “Vista” e cila në atë periudhë ka qene duke punuar ne shtrirjen e rrjetit te internetit fakt ky qe është vërtetuar edhe me dëgjimin e dëshmitareve dhe dëgjimin e palëve ndërgjyqës ne procedure e qe po ashtu ky fakt është vërtetuar edhe me procesverbalin e dt. 03.11.2015. Ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar shumen prej 1410 € në emër të dëmit me kamat ligjore prej 8 % dhe shpenzimet e procedurës të specifikuara, për përpilimin e padisë 60 €, përgjigjen në ankese 104€, për 7 seanca te mbajtur 945 € gjithsejta 1109 €

I autorizuari i të paditurës av. R. G, në tersi e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit duke pretenduar se e paditura fare nuk ka vepruar në vitin 2015 në zonën që përshkruhet në padi andaj si rezultat i mos veprimit të tyre nuk ka mundur te shkaktoi ndonjë dem paditësit. Nga regjistri i klientëve të regjistruar te e paditura provohet fakti se paditësi se është kyqur në internet me dt. 27.12.2020, ka kontestuar provat e propozuara nga paditësi . Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se provat e administruara nuk kanë arritur te dëshmojnë dhe provojnë se e paditura është shkaktare e zjarrit në shtëpinë e paditësit. Fillimisht ka kontestuar procesverbalin e KEDS me nr. 2563 te dt. 03.11.2015 me pretendimin se ky procesverbal dhe ky shikim në vend ngjarje nuk ka qene i autorizuar nga gjykata, i njëjti është subjektiv pasi qe fillimisht është dyshuar se shkaktari i dëmit ka qenë KEDS dhe si rezultat i saj ai procesverbal është i një anshëm, por gjithashtu nga ai procesverbal nuk vërtetohet se me cilin veprim të paditurës ka ardhur deri te shkaktari i zjarrit dhe kontakti i telave ne shtyllë elektrike. Për me tepër procesverbali i lartë përmendur nga dëgjimi i anëtarëve te komisionit qe e kanë hartuar në cilësi te dëshmitarit është provuar se i njëjti është hartuar vetëm mbi bazën e deklaratës e palës paditëse, ndërsa në teren këta dëshmitar – ky komision vlerësues nuk ka vërejtur as nuk ka parë të jetë marrë ndonjë veprim nga e paditura apo te jetë gjetur ndonjë mjetë i te paditurës ne vendngjarje qe mund te ketë shkaktuar kontaktin e telave elektrike. Vetë paditësi duke u dëgjuar ne cilësi të palës ka theksuar se nuk e ka parë kush e ka shkaktuar dëmin, por ka kuptuar për ketë ne deklaratat e zyrtareve te KEDS-it.

Edhe eksperti i elektros ne ekspertizën e tij ka konstatuar se dëmi i shkaktuar në shtëpinë e paditësit ka ardhur si rezultat i këputjes së përcuesit zero ngase tensioni i pajisjeve një fazore është 220V e ne raste te këputjes së përcuesit zero tensioni mundë te shkojë deri ne 400 V dhe pajisjet e dedikuara me 220 V nuk e durojnë ketë tension dhe vije deri tek dëmtimi i këtyre pasjeve. Duke sqaruar mendimin e tij me shkrim ne seance gjyqësore, në procesverbalin e datës 14.02.2024 ka theksuar se përgjegjësia për mirëmbajtjen e rrjetit është e KEDS-it, ndërsa është

përgjegjësi e KEDS-it të provoj dhe të bartë përgjegjësinë tek kompania punë kryerëse, ndërsa unë ne vende ngjarje nuk kam qenë ,nuk e kam parë kush ka kryer punët, unë nuk e di saktësisht ku ka ndodhur këputja e telit – zeros dhe kontakti me telat e tjerë. Përfundimisht ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet dhe të detyrohet paditësi me shpenzimet e procedurës të specifikuara për dy ankesa nga 156 euro, taksa gjyqësore për ankesë 60 euro, për 5 seanca nga 135 euro, gjithsejtë 1047 euro.

Gjykata në bazë të nenit 8 te LPK beri administrimin e provave të propozuara nga palët dhe atë ka bërë leximin e procesverbalin nr.2563 të datës 03.11.2015,listën e pajisjeve te konsumatorit dt.27.10.2015, kërkesën për kompensimin e demit dt.28.10.2015, ekspertizën e ekspertit te elektros Besnik Fejza dt.17.01.2024 ka dëgjuar ne seance ekspertin e elektros dhe dëshmitarët Valon Gashi dhe Sherif Sallahu e po ashtu ne cilësi te palës ka dëgjuar paditësin R.Tdhe përfaqësuesin ligjor të paditurit Eshref Mazreku.

Pas vlerësimit të provave veç e veç dhe te ndërlidhura me njëra tjetrën gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Paditësi me padi fillimisht ka paditur KEDS distriktin ne Prizren dhe N.P Vista me përfaqësues Eshref Mazreku nga Sopija.

Në procesverbalin e datës 27.09.2017 paditësi është tërhequr nga padia e te paditurës se parë KEDS distrikti ne Prizren i cili fakt është konstatuar edhe ne procesverbalin e datës 27.11.2013 . Nga kërkesa për kompensimin e demit e dt.28.10.2015 gjykata ka provuar faktin se paditësi iu është drejtuar kompanisë për furnizim me energji elektrike me kërkesë për vlerësim dhe kompensim te demit të shkaktuar nga energjia elektrike. Ndaj kësaj kërkesë e paditura ka reaguar duke nxjerre ne teren komisionin vlerësues në përbërje të Sh. Sa, V. G ( të dëgjuar si dëshmitarë në këtë çështje) dhe S. K ( tani i ndjerë).

Nga ky procesverbal Gjykata për kundër faktit se në të njëjtin qëndron konstatimi se firma Vista për montimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit kabllovik gjatë tërheqjes e kabllos ka këputur përçuesin zero dhe ka shkaktuar djegien e pajisjeve te paditësit , askund nuk e ka vërtetuar se ku ka ndodhur ajo këputje, nuk është fiksuar asnjë provë për këtë këputje të supozuar për më tepër ne këtë procesverbal qëndron konstatimi se punëtorët kujdestar Sh. E dhe S. E, pas ndodhjes se demit kanë intervenuar në trafo dhe kanë rregulluar dy përçues të tensionit të ulët dhe dy siguresa 250A.Nga ky procesverbal por edhe nga dëgjimi në cilësi të dëshmitarëve të autorëve të këtij procesverbali nuk është provuar koha, vendi dhe mënyra se si ka ardhur tek këputja e përçuesit zero.I gjithë konstatimi në procesverbal sipas dëshmitarëve është bërë mbi bazën e deklaratës së të dëmtuarit R. T, se kinse firma Vista ka punuar në shtrirjen e rrjetit të internetit në atë zonë. Në anën tjetër vetë paditësi i dëgjuar në cilësi të palës ka mohuar të ketë parë firmën Vista duke punuar në rrjet, duke u deklaruar se ka kuptuar nga punëtorët e KEDS-it dhe deklaratat e tyre të cilët kishin thënë se : “Vista ka punuar në fshat atë ditë”, ka deklaruar gjithashtu se në atë kohë nuk ka qenë i lidhur në rrjetin e internetit të firmës Vista, ndërsa më vonë është lidhur në atë rrjetë por duke shtuar se rrjeti i firmës Vista ka qenë i vendosur nëpër shtylla elektrike, ndërsa nga deklarata e punëtorëve të KEDS-it ka kuptuar se Firma Vista ka qenë duke punuar me bager ne tokë e jo në shtyllë, ndërsa a ka këputur ndonjë kablo në tokë nuk e dinë. Në pyetjen e Gjykatës se a kishte parë ndonjë tel në tokë në ditën kritike është përgjigjur Jo, nuk e kam parë dhe nuk kam dalë nga shtëpia atë ditë, që tregon se e gjithë ngjarja është ndërtuar pas ushtrimi të kërkesës për kompensim në KEDS me datën 28.10.2015.

Me dëgjimin e dëshmitarëve dhe palëve në procedurë nuk është vërtetuar përgjegjësia e të paditurës për demin, për më tepër eksperti Besnik Fejza duke sqaruar mendimin me shkrim në

procesverbalin e dt.14.02.2024 ka theksuar se nuk ka mundur të saktësoj ku ka ndodhur këputja e përçuesit zero, e gjithë ekspertiza është mbështetur në deklaratimet e komisionit të KEDS-it në procesverbal të datës 03.11.2015,ndërsa si ekspert nuk ka parë që të ketë patur në shkresat e lëndës ndonjë leje për punë, për operatorin Vista për periudhën kohore si në padi edhe pse ka kërkuar nga palët të sigurohet një provë e tillë, nga palët më është ofruar vetëm një kontratë e cila mbanë numrin 80 e datës 01.06.2019 e lidhur mes KEDS dhe Vista SH.P.K, e nga ku provohet se vetëm në vitin 2019 KEDS ka pasur marrëveshje për vendosjen e kabllot te internetit me Vistën. Sipas ekspertit një marrëveshje e tillë ka qenë e obligueshme nga shkresat e lëndës-procesverbali i hartuar nga punëtorët e KEDS-it nuk kam parë ndonjë provë që do të konstatonte veprimet e marra nga Vista . Koha e ndërhyrjes 14:22,fillimi i punës 14:40 dhe përfundimi i punës 15:10 me datë 17.10.2015 tregon ndërhyrjen e punëtorëve të KEDS-it në trafo, ku kanë ndërruar dy siguresa ,të cilat kanë qenë të djegura dhe ky është ditarë pune për punëtorët e KEDS-it por nuk provon asgjë për Vistën. Për Gjykatën ekspertiza e këtij eksperti në veçanti sqarimet e dhëna në seancë kanë qenë bindëse për qka edhe gjykata iu jep besimin e plotë. Në këtë çështje nga paditësi nuk është arrite të provohet baza e kërkesëpadsisë e aq më pakë lartësia e sajë, ngase sa i për ketë bazës nuk ka asnjë procesverbal të hartuar nga policia apo zjarrfikësit, nuk ka ndonjë dëshmi të jetë inicuar ndonjë procedurë me qëllimi të vërtetimi të fajësisë ,ndërsa baza për kompensimin e dëmit rezulton nga përgjegjësia për fajin. Ndërsa kërkesa në shumë prej 1410 eurosh duke u mbështetur vetëm në një shkresë pa datë, pa numër dhe pa autorë është tërësisht e pa pranueshme si provë dhe jo bindëse për gjykatën .Edhe procesverbali për dëmin i hartuar nga komisioni i KEDS-it nuk ka përshkruar asnjë pajisje apo dëm që kanë konstatuar në vendngjarje me rastin e inspektimit, nuk ka asnjë pajisje të evidentuar si të djegur . Në drejtim të të provuarit të lartësisë së dëmit edhe nuk ka pasur ndonjë propozim për provë nga pala paditëse.

Andaj nga të gjeturat si më lartë Gjykata gjene se kërkesëpadija është tërësisht e pa bazë, dhe nuk ka mbështetje ne nenin 136 paragraf 1 të LMD-së, ku thuhet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tijë”*

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marr në përputhje me nenin 452 par.1 të LPK-së

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE**  
**C.nr. 999/23 të dt. 28.05.2024**

**Sek. Juridike**  
**Fitnete Kabashi**

**Gj y q t a r i**  
**Robert Tunaj**

**KESHILLE JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejte ankese në afat prej 15 dite pas marrjes se te njëjtit, Gjykatës se Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.